



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/570

Datë: 26.12.2018

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, nenit 24, nenit 40 paragrafi 2 pika a,c,g, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), nenit 2 dhe 8 të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.88/25 nëntor 2010), dispozitave të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.27/03 qershor 2008), nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja e,h, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës:12.11.2008, ftesës për debat-konsultim publik nr.04/128 datë: 25.10.2018, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -XIII- të mbajtur me datë: 21.12.2018 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN RREGULLORËS PËR TAKSA NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE PËR  
VITIN 2019

1. Miratohet me ndryshime dhe plotësime Rregullorja për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale për Komunën e Malishevës për vitin 2019.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset: Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
3. Rregullorja hyn në fuqi me 1 Janar të vitit 2019.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

MAPL-së

Drejtorive të KK-së

Arkivit të Komunës.

